

Statuti i Shoqatës Kulturore Shqiptare KOSOVA sh.r.

### § 1 Emri, selia , viti fiskal

§ 1 Nr. 1 Shoqata mban emrin "Shoqata Kulturore Shqiptare KOSOVA sh.r."

Ajo është regjistruar në Gjykatën Themelore në Freiburg, prandaj mban shtojcën "sh.r."

§ 1 Nr. 2 Shoqata e ka selinë në Freiburg.

Shoqata është themeluar më 28.11.2013.

§ 1 Nr. 3 Shoqata është neutrale nga pikëpamja politike, racore dhe fetare.

§ 1 Nr. 4 Viti fiskal i shoqatës është viti kalendarik.

§ 1 Nr. 5 Shoqata ndjek vetëm qëllime bamirëse jofitimprurëse sipas kuptimit të dispozitës "Për lehtësira tatimore " të Kodit Tatimor.

### § 2 Qëllimi i Shoqatës

§ 2 Nr. 1 Qëllimi i Shoqatës është të promovojë

a ) kulturën,

b ) mendimin global dhe tolerancën në të gjitha sferat e kulturës dhe mirëkuptimin mes popujve,

c ) arsimimin, edukimin dhe

d ) sportin.

§ 2 Nr. 2 Qëllimet e parapara me statut realizohen para së gjithash përmes:

a) Organizimit të aktiviteteve muzikore, shfaqjes së filmave, leximeve publike me shkrimtarë, ekspozitave e formave të ndryshme të artit, produksioneve teatrale.

b) Nxitjes së takimeve mes gjermanëve dhe shqiptarëve në Gjermani, si dhe shkëmbimin e informacioneve mbi Gjermaninë dhe Shqipërinë.

c ) Organizimit të kurseve të gjuhës amtare, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë.

d) Promovimit të edukatës fizike, p.sh. duke organizuar turne të futbollit, përmes organizimit të stërvitjeve të rregullta në sporte të ndryshme etj.

§ 2 Nr. 3 Shoqata është jofitimprurëse; ajo nuk synon përfitime ekonomike.

§ 2 Nr. 4 Fondi i Shoqatës mund të përdoret vetëm për qëllimet e parapara me statut. Anëtarët, duke përfshirë edhe kryesinë, **nuk marrin përfitime** nga shoqata.

§ 2 Nr. 5 Asnjë person nuk mund të favorizohet duke e shpërblyer jashtë rregullave të statutit të shoqatës ose duke e shpërblyer në mënyrë disproporcionale.

### § 3 Anëtarësimi

Anëtar i Shoqatës mund të jetë çdo person fizik ose juridik. Rreth aplikacionit për anëtarësim vendos Kryesia e Shoqatës.

#### **§ 4 Përfundimi i anëtarësisë**

Anëtarësia përfundon në raste të

- a) vdekjes së anëtarit
- b) dorëheqjes vullnetare,
- c) shlyerjes nga lista e anëtarëve,
- d) përjashtimit nga Shoqata.

Dorëheqja vullnetare bëhet duke e njoftuar me shkrim njërin nga anëtarët e Kryesisë. Dorëheqja mund të bëhet vetëm në fund të vitit kalendarik duke e bërë njoftimin tre muaj para përfundimit të vitit. Anëtari me vendim të kryesisë mund të shlyhet nga lista e anëtarëve, nëse nuk e bën pagesën vjetore pasi të jetë paralajmëruar dy herë për pagesën e anëtarësisë. Në lidhje me vendimin për shlyerje nga lista anëtari duhet të njoftohet me shkrim. Anëtari që ka shkelur rëndë interesat e shoqatës mund të përjashtohet me një vendim në Kuvendin e Shoqatës. Para se të merret vendimi anëtarit duhet t'i jepet mundësia për të justifikuar veten personalisht. Deklarata me shkrim e anëtarit në fjalë duhet të lexohet në kuvendin e Shoqatës.

#### **§ 5 Pagesa e anëtarësisë**

Anëtarët duhet ta paguajnë anëtarësinë. Shuma e pagesës dhe afati i kryerjes së pagesës përcaktohet nga Kuvendi i Shoqatës. Anëtarët e nderit janë të përjashtuar nga detyrimi për pagesë.

#### **§ 6 Donacionet**

Kontributet (donacionet) vullnetare mund të paguhen nga anëtarët dhe joanëtarët për të promovuar qëllimin e Shoqatës sipas statutit të saj.

Çdo donacion mund të jetë i lidhur me një qëllim të veçantë, me kusht që ai të përputhet me detyrat sipas nenit 2.

#### **§ 7 Organet e Shoqatës**

- a) Kryesia
- b) Kuvendi

#### **§ 8 Kryesia**

Kryesia sipas kuptimit të dispozitës të nenit 26 BGB përbëhet nga

- a) Kryetari
- b) Zëvendëskryetari
- d) Arkatari

Shoqata do të përfaqësohet në gjykata dhe jashtë gjykatave bashkërisht nga dy anëtarë të kryesisë.

Një person nuk mund t'i ushtrojë disa detyra në kryesi.

### **§ 9 Mandati i Kryesisë**

Kryesia zgjedhet nga Kuvendi i Shoqatës për një mandat dyvjeçar i cili fillon nga dita e zgjedhjeve. Kryesia e ushtron funksionin e saj deri sa të zgjedhet kryesia e re. Nëse një anëtar i Kryesisë gjatë mandatit të tij largohet nga kryesia, kryesia e zgjedh një anëtar (nga radhët e anëtarëve të Shoqatës) që e zëvendëson atë për pjesën e mbetur të mandatit të anëtarit që ka dhënë dorëheqje.

### **§ 10 Vendimet e Kryesisë**

Kryesia i merr vendimet në përgjithësi në mbledhjet e kryesisë që duhet të thirren nga Kryetari ose nga Zëvendëskryetari me shkrim, me telefon ose me email. Në çdo rast, afati për thirrjen e mbledhjes është minimum tri ditë para mbajtjes së mbledhjes. Nuk është e nevojshme të bëhet njoftimi i rendit të ditës. Kryesia ka kuorum nëse të paktën janë të pranishëm dy anëtarë të kryesisë, duke përfshirë Kryetarin ose Zëvendëskryetarin. Vendimet merren me shumicë të votave të vlefshme. Në rast votimi të barabartë, vendos vota e kryesuesit të mbledhjes së kryesisë. Mbledhjet e kryesisë i udhëheq Kryetari, ose në mungesë të tij Zëvendëskryetari. Vendimet e kryesisë duhet të shënohen në procesverbal, të nënshkruhen nga kryesuesi i mbledhjes dhe të ruhen si dëshmi. Vendimi i kryesisë mund të miratohet me shkrim ose me telefon, në qoftë se të gjithë anëtarët e japin pëlqimin e tyre për vendimin që do të miratohet.

### **§ 11 Kuvendi**

Në Kuvendin e Shoqatës të drejtë vote ka çdo anëtar i pranishëm - gjithashtu edhe çdo anëtar nderi.

Kuvendi i Shoqatës është përgjegjës për çështjet e mëposhtme:

- a) Pranimi i raportit vjetor të kryesisë; Shkarkimi i Kryesisë.
- b) Caktimi i shumës dhe afatit të pagesës së anëtarësisë.
- c) Zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të kryesisë.
- d) Vendos për ndryshimin e statutit dhe për shpërbërjen e Shoqatës.
- e) Emërimin e anëtarëve të nderit.

### **§ 12 Thirrja e Kuvendit të Shoqatës**

Të paktën një herë në vit, mundësisht në tremujorin e fundit, duhet të mbahet kuvendi vjetor i Shoqatës. Kuvendin e thërret Kryesia e Shoqatës. Njoftimi bëhet me shkrim dy javë para kuvendit. Në njoftim duhet të shënohet rendi i ditës. Afati fillon ditën pas dërgimit të ftesës. Do të konsiderohet se anëtari e ka marrë letrën e ftesës në qoftë se ajo është dërguar me shkrim në adresën e fundit që e ka dhënë anëtari. Rendin e ditës e cakton Kryesia.

### **§ 13 Vendimet e Kuvendit**

Kuvendin e udhëheq Kryetari i Shoqatës, në mungesë të tij Zëvendëskryetari ose ndonjë anëtar tjetër i kryesisë. Nëse në kuvend nuk është i pranishëm asnjë anëtar i kryesisë, kuvendi e cakton një kryesues të Kuvendit. Procesverbalin e mban procesmbajtësi. Nëse procesmbajtësi nuk është i pranishëm, kryetari e cakton një procesmbajtës. Kryetari e përcakton llojin e votimit. Votimi duhet të bëhet me shkrim, në qoftë se një e treta e anëtarëve me të drejtë vote të pranishëm në kuvend e kërkon këtë. Kuvendi i Shoqatës nuk është i hapur për publikun. Kryetari i kuvendit mund të lejojë

pjesëmarrjen e mysafirëve. Lidhur me pjesëmarrjen e shtypit, radios dhe televizionit vendos kuvendi. Çdo kuvend i thirrur në mënyrë të rregullt, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm, ka kuorum. Kuvendi i merr të gjitha vendimet në përgjithësi me shumicën e thjeshtë të votave të vlefshme; abstenimet nuk merren në konsideratë. Megjithatë, ndryshimi i statutit (duke përfshirë qëllimin e shoqatës) mund të bëhet vetëm me tri të katërtat e votave të vlefshme, ndërsa shpërbërja e shoqatës me katër të pestat e votave. Për zgjedhjet vlen si në vijim: Nëse gjatë votimit të parë asnjë kandidat nuk e arrin shumicën e votave të vlefshme të hedhura, do të zhvillohet një balotazh midis kandidatëve, të cilët kanë marrë më së shumti vota. Lidhur me vendimet e Kuvendit mbahet procesverbali, i cili duhet të nënshkruhet nga kryesuesi përkatës dhe procesmbajtësi. Ai duhet të përmbajë të dhënat si në vijim: kohën dhe vendin e mbajtjes së kuvendit, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe të procesmbajtësit, numrin e anëtarëve të pranishëm, rendin e ditës, rezultatet e votimeve dhe mënyrën e votimit. Në rast ndryshimi të statutit duhet të shënohet dispozita që ndërrohet.

#### **§ 14 Plotësimi i rendit të ditës**

Çdo anëtar mund të kërkojë me shkrim një javë përpara se të mbahet Kuvendi nga kryesia e Shoqatës që një çështje e caktuar të vendoset në rendin e ditës. Kryetari duhet ta plotësojë në përputhje me propozimin e bërë në fillim të kuvendit rendin e ditës. Lidhur me propozimet për plotësimin e rendit të ditës, të cilat do të bëhen gjatë Kuvendit, vendos vetë Kuvendi. Për pranimin e propozimit është e nevojshme një shumicë prej tre të katërtat e votave. Ndryshimet e statutit, shpërbërja e Shoqatës si dhe zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të Kryesisë mund të bëhen vetëm në qoftë se janë njoftuar anëtarët paraprakisht përmes rendit të ditës për kërkesat e tilla.

#### **§ 15 Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit**

Kryesia në çdo kohë mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Shoqatës. Mbledhja duhet të thirret nëse këtë e kërkon interesi i Shoqatës, ose në qoftë se një e dhjeta e të gjithë anëtarëve e kërkon një gjë të tillë me shkrim nga kryesia, duke deklaruar paraprakisht qëllimin dhe arsyet. Për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit do të zbatohen nenet 10, 11, 12, dhe 13 të statutit të Shoqatës.

#### **§ 16 Shpërbërja e Shoqatës**

§ 16 Nr. 1 Lidhur me shpërbërjen e Shoqatës mund të vendoset vetëm në një Kuvend të Shoqatës me shumicë votash si parashihet në pikën 12 të statutit. Nëse kuvendi nuk vendos ndryshe Kryetari dhe Zëvendëskryetari janë të autorizuar bashkërisht si likuidatorë. Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe në rast se Shoqata shpërbëhet për një arsye tjetër, ose e humb kapacitetin e saj ligjor.

§ 16 Nr. 2 Në rast shpërbërjeje të shoqatës ose në rast se shoqata i humb lehtësirat tatimore, pasuria e shoqatës i kalon një korporate publike ose një tjetër korporate që gëzon lehtësira tatimore, për përdorim për promovimin e kulturës.

Statuti është ndryshuar dhe miratuar në mbledhjen e mbajtur më 23.12.2013.

Freiburg, më 23.12.2013